



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2853 /2022
Data: 19.04.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tretë -III- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.03.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: z. **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës, **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.
4. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.
5. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2021.
6. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

Qamush Brava thekson:- në mbledhjen e kaluar i kam kërkuar disa përmirësime dhe u dakordua që përmes sekretarisë me ua dërguar drejtorëve dhe përmirësimet në disa drejtori nuk janë bërë dhe përmirësimet që kam kërkuar me u bërë mundësisht të përmirësohen. Vendimin të cilin e kemi marr për zgjedhjen e këshillave të fshatrave është anti ligjorë për shkak se neni pesë paragrafi tre parasheh përbërjen gjinore dhe është dashur me u respektuar kuota gjinore . Në qoftë se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nëse e shikon mirë do ta kthen në rishqyrtim .

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket përmirësimeve duhet me i shikuar se nuk jam shumë i sigurt, ndërsa sa i përket vendimit për të cilin e potencove , çdo vendim që miratohet në Kuvend dërgohet në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë dhe vendimi për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave nga Ministria është kthyer që është në përputhje me ligjin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- gjendja me pandemin në komunën tonë është stabilizuar dhe afër një muaj e gjysmë nuk kemi asnjë rast pozitivë . Sa i përket vaksinimit interesimi te qytetarët ka rënë dhe deri më tani janë ta administruara 9732 doza.

Refet Kalisi thekson:- a ka ende qytetar të cilit nuk janë vaksinuar.

Zaim Bela thekson:- a është obligative doza e tretë për me u marr. A janë duke u bërë testime ende në QKMF

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- doza të administruara janë 9732 doza që do të thotë janë qytetarët që janë vaksinuar me tri doza , kështu që ka ende qytetarë që nuk janë vaksinuar. Sa i përket dozës së tretë është rekomandim nga Ministria e Shëndetësisë . Testimet janë duke u bërë në QKMF.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITET PËR VITIN 2021

4. Raporti i punës së katër komiteve konsultative për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2021

5. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Resul Suma thekson:- në këshillin komunal për siguri në bashkësi a keni menduar me diskutuar për qenët endacak sepse qytetarët po ndihen të rrezikuar sepse te ajo pjesa te rrethi po mblidhen shumë qen dhe mund të shpërndajnë edhe epidemi të ndryshme.

Hyriete Isufi thekson:- është muaji i anti drogës dhe duhet të bëjmë më shumë për këtë çështje për me parandaluar për shkak se duhet shumë punë dhe nuk po dimë si me vepruar sepse nuk është ka shkon në terezi. Është mirë që këta të cilët janë në moshë më të re me biseduar më shumë me të rinjtë.

Zaim Bela thekson:- këtu përfshihet vetëm komandanti i stacionit policorë por në të kaluarën ka qenë i përfshirë edhe komandanti i vijës së gjelbërt dhe në mbledhje të kuvendit kam propozuar që edhe komandanti apo përgjegjësi i vijës së gjelbërt me marr pjesë në mbledhje të KKS-së

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e qenve endacak e kemi diskutuar edhe në legjislaturën e fundit por edhe tash e kemi diskutuar me asociacionin e komunave, në forumet të cilat i kemi mbajtur , në bord të drejtorëve dhe KKS . Sa i përket rrethit që u potencua e kemi një plan për me gjelbëruar atë pjesë dhe me mbjell me lule. Kemi pasur një trajnim me përfaqësuesit e Ambasadës së Anglisë që ka pasur të bëjë me riintegrimin e personave të kthyer nga lufta dhe në kuadër të këtij takimi kemi diskutuar edhe për luftimin e këtyre dukurive negative dhe kemi menduar që përmes IOM-it dhe Ministrisë së Brendshme, Ambasadës së Anglisë jemi munduar me lobur në këtë drejtim për projekte të ndryshme. Komandanti i vijës së gjelbërt merr pjesë në takim por me udhëzim administrativ përcaktohet se kush është pjesë e KKS-së. Pavarësisht mbledhjeve të KKS-së edhe jashtë mbledhjeve takim kam pasur me komandantin e policisë kufitare, të vijës së gjelbërt dhe të stacionit policorë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

6. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas rendit të punës.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hyriete Isufi thekson:-komuna e ka bërë një kontratë për me i lidhur printerët por ende nuk janë lidhur, e kemi pasur kohën e testimave dhe fatmirësisht një kompjuterë na ka funksionuar se për ndryshe e kemi pasur problem këtë çështje . A keni filluar ndonjë procedurë për çështjen e psikologut se seriozisht nuk është gjendja mirë.

Hanumshahe Dibrani thekson:- konkursi që ka qenë te QKMF-ja për pastruese a ka qenë korrekt.

Malik Berisha thekson:- te shkolla fillore “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë trotualet shfrytëzohen për parking dhe është problem për nxënësit , mirëpo mund të shfrytëzohet oborri për parking deri sa të bëhet zgjidhja.

Ibadete Kalisi thekson:- çështja e ndriçimit të rrugëve në fshatin Seçishtë ka probleme dhe është e mundshme që me u rregulluar kjo çështje. Bllokimi i rrugës që po bëhet prej kamionëve është mirë me bërë ndonjë zgjidhje sepse po bllokohet.

Hisni Luri thekson:- sa i përket printerëve jemi duke u munduar që çdo shkollë me pasur nga një printerë apo me lidhur ndonjë kontratë tjetër për shkak se nuk është zgjidhje kjo sepse janë printerët por nuk janë të aktivizuar. Sa i përket psikologëve e kemi menduar këtë çështje për me pranuar një psikologë për të gjitha shkollat e komunës. Për çështjen e trotuarit te shkolla fillore “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë e kemi diskutuar këtë çështje dhe po duam me i ndryshuar rrethojat më brenda në mënyrë që me krijuar një hapësirë për parking.

Sherif Berisha thekson:- nëse nuk ndërhyjnë drejtoria e arsimit të çështja e trotuarit në fshatin Gorancë lirishtë njoftone policinë , për ndryshe komuna duhet të mendojë për një rrugë anësore ose transit e cila është paraparë shumë më herët.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- sa i përket konkursit në QKMF shumë mirë e dinë që herën e parë dështoi shkaku që nuk u plotësuan kriteret nga kandidatët dhe u dashtë përsëri me rishpallur . Konkursi ka shkuar në bazë të rregullave dhe procedurave , e për gjithë ata të cilët janë të pakënaqur është afati ligjorë që mund të parashtrajnë ankesë.

Arsim Dernjani thekson:- procedurat e tenderimit për ndriçimin publik janë kryer dhe është përzgjedhur kompania dhe së shpejti do të fillojnë procedurat për riparimin e ndriçimit.

Resul Suma thekson:- pjesa e deponisë së mbeturinave në fshatin Dimcë është mirë me pastruar dhe me vendosur kamera në atë pjesë.

Nora Xhoni thekson:- a kanë filluar procedurat për çështjen e lloptopëve për asamblenë komunale.

Kryesuesi thekson:- procedurat kanë filluar dhe pritët me u pajisur me lloptop për asamblenë komunale.

Refet Kalisi thekson:- në atë pjesën e trotuarit ka lagja e Ujit të Thartë është varrosur një qen por është shumë afër trotuarit dhe ka dal në sipërfaqe , është mirë me marr iniciative me zhvendosur për shkak se kundormonë erë e rëndë. Kompania që është duke i kryer punimet i ka dëmtuar drunjët dhe është mirë i rregulluar.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e rrugës transit në fshatin Gorancë e di që është diskutuar edhe më herët për momentin nuk mund të bëjmë zgjidhje për shkak se buxheti është i miratuar për këtë vit dhe kur të fillojmë me projeksionet buxhetore për vitin 2023 duhet të propozohet me hyjë si projekt duke i shikuar mundësitë buxhetore . Unë jam shumë seriozë me parë se ku ka shkelje nëpër konkurse jo vetëm te ambulanta por në çdo konkurs nëse ka ndonjë fakt sepse jemi duke u munduar me krijuar një barazi në konkurse. Çështjen e deponisë në fshatin Dimcë e kemi diskutuar dhe afër pesë apo gjashtë muaje që është bërë dhe jemi duke u munduar me i eliminuar. Për çështjen e rrugës jemi tu munduar që së bashku me kompaninë “Sharcem” me bërë zgjidhje që si projekt ide me kaluar nëpër “Sharcem” por të shohim në të ardhmen.

Sherif Berisha thekson:- mbikalimi që është te stacioni trenit është mirë të pastrohet dhe të rregullohet .

Mehmet Ballazhi thekson:- dje kemi pasur një takim me përfaqësuesit e kompanisë së “Infrakosit” dhe e kanë marr përsipër me rregulluar.


Hanumshahe Dibrani thekson:-a ka planifikuar komuna me shpërndarë ndihma për muajin e ramazanit për familjet të cilat janë me social dhe a keni biseduar me përfaqësuesit e bashkësisë islame për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- kemi biseduar për këtë çështje dhe besoj që do të kemi një iniciativë për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:40

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

